

Forca e Sigurisë e Kosovës kërkon të bëhet një ushtri

10/01/2013

Ministri i FSK-së Agim Çeku pret që 2013 të jetë një vit që vendi të ketë një ushtri.

Nga Safet Kabashaj për Southeast European Times në Prishtinë – 10/01/13

Autoritetet e Kosovës kanë në plan të transformojnë Forcat e Sigurisë të Kosovës të armatosura lehtë, në një ushtri këtë vit. Forca, e cila u krijua në janar 2009 sipas Planit Ahtisari, përbëhet nga 2,500 anëtarë shumë-etnikë aktivë e 800 rezervë. Ajo është kryesisht përgjegjëse për reagimin ndaj krizave.

Në katër vitet e fundit, forca veprimi nën mbikëqyrjen e KFOR-it për t'u bërë një strukturë profesionale. KFOR e mësoi atë e mbikëqyni zhvillimin e saj, duke njoftuar arritjet e saj tek NATO, që do të marrë vendimin përfundimtar mbi të ardhmen e forcës.

Aleksandër Villing, zëdhënës i KFOR-it, tha për *SETimes* se forca e sigurisë ka bërë përparim të madh, por aftësia e saj e plotë funksionuese do të përcaktohet nga NATO.

"Vendet e NATO-s po shqyrtojnë kohën e duhur për miratimin përfundimtar të FSK-së," tha Villingu. "Këshilli i Atlantikut të Veriut, organizmi më i lartë vendim-marrës i NATO-s, do të marrë një vendim politik mbështetur në vlerësimin e autoriteteve ushtarake të NATO-s."

Këshilli pritet të vendosë mbi statusin e forcës në takimin e tij të qershorit.

Zyrtarë e Kosovës janë optimistë.

Remzie Zeqiraj, zëdhënëse e ministrisë së FSK-së, tha për *SETimes* se rekomandimet e KFOR-it NATO-s janë të qarta: forca ka arritur aftësitë e plota funksionale.

"Tani presim një konfirmim mbi rekomandimin e KFOR-it për FSK," tha Zeqiraj

Ministri i FSK-së Agim Çeku i tha parlamentit muajin e kaluar se "2013 do të jetë viti i ushtrisë së Kosovës."

Rada Trajkoviç, një deputete serbe në asamblenë e Kosovës shprehu shqetësim se transformimi i FSK-së do të jetë një burim paqëndrueshmërie.

"Një ushtri me një komandë shqiptare [të Kosovës] është një faktor paqëndrueshmërie për serbët në Kosovë, pasi do të ishte një ushtri shqiptare [e Kosovës] me pjesëmarrje të vogël nga etnitë e tjera," tha Trajkoviçi.

Marko Saviç, një studjues në Qendrën për Politikën e Sigurisë në Beograd, mendon se një transformim i FSK në një forcë të armatosur me përmasa të plota do të kërkojë kohë.



NATO do të marrë vendim mbi transformimin e FSK-së. [Laura Hasani/SETimes]

"Procesi mundet të nisë, por me siguri nuk do të përfundohet në 2013," tha Saviçi për *SETimes*.

Ai tha se me gjithë kundërshtimin e planit nga serbët e Kosovës, ai pritet të miratohet.

"Serbia do të vazhdojë të punojë me NATO-n; ajo thjesht do të bëjë kështu, duke ditur rëndësinë e madhe për sigurinë rajonale," tha Saviçi.

Florian Qehaja, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Studime të Sigurisë, të Kosovës, tha se zhvillimet e reja në Kosovë, veçanërisht pas një pakësimi të vazhdueshëm në praninë e KFOR-it u kërkojnë autoriteteve të shqyrtojnë mandatin e FSK-së.

"Kosova ka nevojë për një ushtri të vogël, pak më të madhe se FSK ... të aftë për detyrat e mbrojtjes civile, pjesëmarrjen në misionet paqeruajtëse dhe sigurimin e integritetit të Kosovës," tha Qehaja për *SETimes*.